



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.109, datë 27.06.2024

PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL,
ME KËRKESË PËR VLERËSIM TË PËRSHPEJTUAR,
PËR PROKUROREN VITJUNA MATA”

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, nenet 159, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “a”, 190 të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenin 97 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të prokurorisë”, si dhe pasi u njoh me raportin e përgatitur nga relatori, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit etik dhe profesional me kërkesë për vlerësim të përshpejtuar, për prokuroren Vitjuna Mata duke e vlerësuar si më poshtë:
 - a. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - b. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - d. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
 - Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar vetëm për shkelje të rënda procedurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përputhje me nenin 95, pika 9 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.
5. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda